



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 2 prill Trupi Gjykses rrëzoi kërkesën e ekipeve të Mbrojtjes të Thaçit dhe Selimit për të urdhëruar Prokurorinë që çfarëdo provash shtesë që ka t'i nxjerrë vetëm për Mbrojtjen, jo dhe për gjykatësit, siç vepohet zakonisht. Të pandehurit argumentuan se nxjerrja e këtyre materialeve për gjykatësit nuk ishte më e nevojshme, sepse paraqitja e provave ka përfunduar.

Në vendim, Trupi Gjykses bëri dallimin mes materialeve që propozohen për pranim si prova në gjykim dhe thjesht nxjerrjes së materialeve. Trupi Gjykses theksoi se aktgjykimi do të mbështetet vetëm në materialet që janë pranuar në dokumentacionin e çështjes gjyqësore. Megjithatë, duke mbajtur parasysh detyrimin në vijimësi të Prokurorisë për nxjerrjen e materialeve, Trupi Gjykses gjykoi se është legjitime që ai të vazhdojë mbikëqyrjen e nxjerrjes së materialeve, për të siguruar që ajo të bëhet në përputhje me Rregulloren, duke pasur parasysh se duhet që të jetë në gjendje të trajtojë aspektet që lindin prej saj, sikurse është edhe kërkesa në fjalë.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit për ndikim të pretenduar të dëshmitarët, më 2 prill, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit pasi konstatoi se ende ekziston rreziku që ai mund të pengojë ecurinë e procesit ose të kryejë vepra penale të tjera. Gjykatësi i Vetëm konfirmoi konstatimet e bëra më parë se rreziku i pengimit të procesit ishte zvogëluar krahasuar me rishikimet e mëparshme të paraburgimit, pasi paraqitja e provave ka përfunduar në një nga çështjet, ndërsa në çështjen tjetër Prokuroria nuk ka të ngjarë të mbështetet në dëshmitarë apo dëshmi që mund të manipulohen.

Sidoqoftë, Gjykatësi i Vetëm vlerësoi se ekzistonte njëfarë rreziku se persona që mund të thirren si dëshmitarë të Mbrojtjes në këtë çështje, identiteti i të cilëve ende nuk dihet, mund të jenë objekt i ndikimit. Gjithashtu, ai mbajti parasysh rolin drejtues të pretenduar të Hashim Thaçi në përpjekjet për të penguar procesin gjyqësor të tij për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ai rikujtoi se këto rreziqe duhen parë edhe në kontekstin e atmosferës mbizotëruese të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë, në veçanti sa u përket hetimeve dhe ndjekjes penale të krimeve që u atribuohen ish-anëtarëve të UÇK-së.

Gjykatësi i Vetëm nuk u bind se kushtet për lirim mund t'i zvogëlonin mjaftueshëm këto rreziqe dhe, bazuar në sa më sipër, konstatoi se vazhdimi i paraburgimit të z. Thaçi ishte ende i arsyeshëm, duke pasur parasysh se procesi po vijon me ritëm të shpejtë.





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**
Nr. 13/2026
Hagë, 09/04/2026

Seancat gjyqësore në këtë çështje që fillimisht ishin planifikuar nga 14 deri në 17 prill, u anuluan. Këto data ishin rezervuar paraprakisht, në rast se do të ishte e nevojshme.

